



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 851/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesues, Rrustem Thaqi dhe Zyhdi Haziri anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e Qerim Rexhaj, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Istogut, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Istog, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.11.2021, mori këtë:

#### V E N D I M

**REFUZOHET** i pabazuar apeli Anr.851/2021, i paraqitur nga Qerim Rexhaj, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Istogut, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Istog, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me të cilin ka kërkuar rinumërimin e fletëvotimeve në Qendrat e Votimit: 0622c, 0604c, 0607c, 0605c, 0620c, për kandidatët e kuvendit komunal në Komunën Istogut nga subjekti politik LVV.

#### A r s y e t i m

Me datë 04.11.2021, Qerim Rexhaj, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Istogut, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Istog, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), ka parashtruar apel me të cilin pretendon se në Qendrat e Votimit 0622c, 0604c, 0607c, 0605c, 0620c, nuk figurojnë në rezultatet e shpallura nga KQZ i votat e votuesve të tij. Kërkon që 7 ti rinumërohen votat e tij në këto QV. Si provë në apel parashtruesi ka bashkangjitur deklaratat e votuesve.

Paneli, pasi që shqyrtoj apelin, si dhe shkresat e lëndës vlerësoi se:

### **Apeli është i pabazuar.**

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mungesë të votave, në bazë të cilave ka kërkuar rinumërim të fletëvotimeve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur mos përfshirje të votave të parashtruesit të apelit gjatë numërimit të votave, për faktin se thëniet e tij nuk mbështeten në asnjë provë konkrete por janë të përgjithshme e jo të konkretizuara, sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mos përfshirje të saktë votave në rezultat përfundimtar, si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankueses nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Paneli i shqyrtoi deklaratat e votuesve të bashkangjitura në apel nga ana e ankuesit, gjeti se të njëjtat nuk janë bazë e mjaftueshme për të vërtetuar se në këto QV ka pasur parregullsi, rrjedhimisht pretendimi ankimor i parashtruesit të apelit se apelin e mbështet në pohimet e votuesve nuk është i argumentuar, për më tepër, paneli rikujton se vota është e fshehur, dhe publikimi i saj shpërfaq vullnetin e çdo votuesi në fletëvotim që është në kundërshtim me parimin kushtetues të fshehtësisë së votës, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të merret si fakt provues pretendimi i tillë se një votues pohon faktin se ka votuar në ndonjërin nga vendvotimet që kandidatja ka pretenduar në apel. Në rastin konkret apeluesi nuk ka paraqitur ndonjë provë tjetër si Formularët e Përputhjes së Rezultateve dhe Formularët e Rezultateve të Kandidatëve, të cilët do shërbenin si provë, andaj në mungesë të provave paneli vendosi që apeli i paraqitur të refuzohet si i pa bazuar.

Apeli i ankuesit u refuzua lidhur me kërkesën për rinumërim të QV me nr. 0622c, 0604c, 0607c, 0605c, 0620c, pasi që sipas evidencës zyrtare të KQZ-së të gjitha fletëvotimet në këto QV, për të gjithë kandidatët e Subjektit Politik LVV, janë rinumëruar dhe nuk mund të rinumërohen edhe një here.


Si përfundim, Paneli vlerësoi se apeli i Qerim Rexhaj, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Istogut, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Istog, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidat apo ndonjë parregullsi, andaj kërkesa e apeluesit për të rinumëruar të gjitha fletëvotimet e kandidatit për kuvend komunal në Komunën e Istogut

për Subjektin Politik LVV, për QV e lartcekura, vlerësohet si i pa bazuar, sipas vlerësimit të panelit shkeljet do duhej të jenë shumë serioze dhe bindëse, si dhe të rezultojnë nga provat e mjaftueshme, bindëse dhe të pa kontestueshme, te cilat në rastin konkret mungojnë.

Për arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr 851/2021 më datën 07.11.2021



*Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.*